

Në bazë të nenit 48, paragrafi 4 të Ligjit për nëpunësit administrativ ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/2014, 199/2014, 48/2015, 154/2015, 05/2016, 142/2016 dhe 11/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 275/2019 dhe 14/2020) dhe në pajtim me nenin 2 të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e shpalljes interne, mënyrën e dorëzimit të kërkesës për avancim, mënyrën e kryerjes së përzgjedhjes administrative dhe intervistës, si dhe mënyrën e vlersimit të tyre dhe numrin maksimal të pikëve nga procedura e përzgjedhjes, në varësi të kategorisë së punës për të cilën është publikuar shpallja interne ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 11/2015 dhe 35/2018 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 303/2020), Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural shpall

**SHPALLJE INTERNE nr 02/2021**  
**për ngritjen në detyrë të nëpunësve administrativë**  
**në Agjencinë për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural**

1. Këshilltar për planifikim, përzgjedhje dhe punësim të personelit, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, kodi i punës UPR0101B01000 - 2 realizues:

**Kushtet e veçanta të punës:**

- Niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës Maqedonase të Kualifikimeve dhe të marrë së paku 240 kredite sipas ECTS ose diplomë të përfunduar VII/1 në fushën e shkencave politike ose juridike,
- njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë,
- të paktën tre vjet përvojë pune në profesion,
- njohuri aktive e njërës prej tre gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);

**Orari i punës:** ditë pune - nga e hëna në të premte / fillimi i orarit të punës nga ora 07.30 deri në 08.30 dhe përfundimi i orarit të punës nga ora 15.30 deri në 16.30 (40 orë pune në javë / 8 orë pune në ditë).

**Paga neto mujore:** përafërsisht 26.257,00 denarë.

Nëpunësit administrativë të punësuar në Agjencinë për Mbështetje Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të cilët plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për plotësimin e vendit të lirë të përcaktuara për nivelin përkatës në Ligjin për nëpunës administrativ dhe në Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës, mund të aplikojnë për shpallje në pozitë në Agjencinë për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural Nr.01-1006/10 datë 27.09.2016 dhe ndryshimet e saj, si dhe:

- të vlerësohet "A" ose "B" në notimin e fundit,
- të jetë në vend punë të një niveli më të ulët ose të jetë në një punë brenda së njëjtës kategori me vendin e punës për të cilën është publikuar shpallja interne,
- të ketë kaluar të paktën dy vjet në të njëjtin nivel dhe
- të mos ketë qenë i disiplinuar në vitin e fundit para shpalljes së shpalljes interne.

Aplikacioni përmban emrin dhe mbiemrin, punën aktuale, nivelin dhe përvojën e punës së kandidatit të aplikuar. Kandidatët mund t'i bashkëngjisin aplikacionit provat e mëposhtme në formë të skanuar:

- certifikata për trajnime të kryera me sukses dhe/ose
- certifikata për mentorim të përfunduar me sukses (si mentor ose nëpunës civil administrativ i mentoruar).

Afati për dorëzimin e shpalljes është 7 (shtatë) ditë nga dita e publikimit të tij në ueb faqen e Agjencisë për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe në ueb faqen e Agjencisë për Administratë. Aplikacioni dorëzohet përmes Regjistrisë të Agjencisë për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim

Rural në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe në adresën zyrtare të e-mailit në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore - oucr@ipardpa.gov.mk. Në aplikim, kandidatët janë të detyruar me përgjegjësi materiale dhe penale të konfirmojnë se të dhënat e paraqitura në aplikacion janë të sakta, dhe provat e paraqitura janë të vërteta me origjinalin.

**SHËNIM:** Kandidati që shënon të dhëna jo të vërteta në aplikim do të skualifikohet nga procedura e mëtejshme pas kësaj shpallje.